



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:171800
Datë: 28.02.2024
Numri i dokumentit: 05390084

C.nr.2857/22

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni civil, gjyqtari Baki Shigjeqi, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.S. me numër personal nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqësojnë Shoqëria e Avokatëve: Studio Ligjore & Financiare “Klinaku” me avokatët e saj, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson B.L. nga Prizreni, me objekt të padisë kompensimi i shpërblimit jubilarë, vlera e kontestit 578.41 euro, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 28.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. RFUZOHET** kërkesëpadia e paditësit B.S. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të: *“DETYROHET e paditura Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal - Prizren, që paditësit në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës në punë të i paguajë (kompensojë) 1 (një) pagë mujore neto në shumën prej 578.41 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë gjerë në pagesën definitive të saj si dhe shpenzimet e procedurës të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm” e pa bazuar*
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi B.S. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij, pranë kësaj gjykate, me datë 23.08.2022, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren, me objekt të padisë kompensimin e shpërblimit jubilarë, vlera e kontestit 578.41 euro.

I autorizuari i paditësit në padi ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura për më tepër se 10 vite në SHSKUK, në Prizren. E paditura Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren edhe përkundër obligimeve, përkatësisht fitimit të së drejtave të cilat rrjedhin nga Kontratën Sektoriale e nënshkruar me 12.06.2018, mes Qeverisë së Kosovës-Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, Ligjit të Punës (nenet 4, 10, 11, 55, 90) dhe kontratës individuale, nuk e ka bërë kompensimin e 1 (një) page neto, ashtu siç i takon sipas përvojës së punës. Lartësia e llogaritjes së një page neto për shpërblimin jubilar, mbështetet në realizimin e pagës në muajin e fundit të paditësit. Sipas të

autorizuarit të paditësit paga mujore neto e paditësit është 578.41 euro e cila vërtetohet sipas listës së pagës. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e vet, i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave, të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura, përmes të autorizuarit të saj, në përgjigjen në padi e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Për më tepër ka theksuar se paditësi marrëdhënien e punës në Spitalin e Përgjithshëm në Prizren e ka themeluar me datë 14.11.2002 ku edhe vazhdon të punojë. Paditësi kërkesën e bazon në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive në nenin 52 e 53 e cila marrëveshje në mënyrë parimore ka rregulluar shumë çështje nga marrëdhënia e punës. Me dispozitat e nenit 52 par 3 parashihet se shpërblimet jubilarë paguhen në afat prej 1 muaji prej ditës kur i punësuari i mbush 10, 20 dhe 30 vjet përvojë pune të pandërprerë i cili quhet vit jubilar. Në rastin konkret, duke u nisur nga fakti se paditësi marrëdhënien e punës tek i padituri e ka themeluar me 14.11.2002 mund të konstatojmë se paditësi tek i padituri 20 vite përvojë pune i ka mbushur me 14.11.2022, pra viti kur nuk është në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale 10.06.2021, andaj ky vit për të ka qenë jubilar. E sipas kësaj paditësit nuk i takon e drejta e shpërblimit jubilar dhe për faktin se paditësi kërkesën e saj e bazon në Kontratën Kolektive Sektoriale të cilës i ka përfunduar afati kohor me datë 10.06.2021 që do të thotë se kjo kontratë nuk ka fuqi vepruese. Në fund i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesë padinë e paditësit ta refuzojë si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, sepse nga përgjigja në padi rezulton qartas se kërkesëpadia e paditësit është e pathemeltë.

Për palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se paditësi është marrëdhënie pune pranë të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren, të njëjtën e ka filluar me datë 14.11.2002 ku edhe vazhdon të punojë dhe në këtë institucion i ka për më tepër se 19 vite përvojë pune. Po ashtu paga bazë e të njëjtit në SPZ është 377.00 euro, fakte këto të vërtetuara nga provat (vërtetimi, lartësia e pagës bruto dhe neto, kontrata e punës e lidhur mes palës paditëse dhe palës paditur) të cilat gjinden në shkresat e lëndës të dorëzuara nga pala paditëse dhe e paditura me përgjigjen në padi.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe atë: vërtetimi nr.755 i datës 26.05.2022 lëshuar nga e paditura lidhur me përvojën e punës dhe lartësinë e pagës bazë, lista e pagave numër EM00037775 e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për paditësen, kontratës së marrëdhënies së punës e lidhur në mes këtu paditësit dhe të paditurës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe e njëjta duhet të refuzohet. Kjo për faktin se pala paditëse e ka bazuar kërkesën për kompensimin e pagës jubilarë në Kontratën Kolektive Sektoriale (KKS), kurse Kontrata Kolektive Sektoriale, e datës 11.06.2018 me nr. të njësisë 01, nr. prot.05-3815, nuk ka zbatueshmëri në periudhën në të cilën paditësi ka arritur vitin jubilar, pasi me nenin 2 të KKS përcaktohet: *“Afati i zbatimit të kësaj kontrate është në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet nga data e lidhjes së saj...”* kontrata është lidhur me datë 11.06.2018, ndërsa duke u bazuar në Mendimin Juridik, për shpërblimin jubilar, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të datës 27.02.2023, në pikë V përcaktohet që

kontrata kolektive sektoriale, aplikohet për periudhën kohore nga data 11.06.2018 - 10.06.2021, ndërsa në pikën IX të po këtij mendimi juridik parashihet që *“punëtorët shëndetësor në bazë të Kontratës Kolektive Sektoriale kanë të drejtë në shpërblimin jubilar siç përcaktohet me nenin 17 të kësaj marrëveshje, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: a) që viti jubilar i punësimit për 10, 20 dhe 30 vjet të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën V, të këtij mendimi juridik dhe b) përvoja e punës për 10, 20 dhe 30 vjet duhet të jetë në institucione shëndetësore te punëdhënësi i fundit”*.

Në bazë të lartcekurave gjykata konstaton se paditësi në periudhën për të cilën aplikohet kontrata kolektive sektoriale (11.06.2018 - 10.06.2021) nuk ka arritur 10 vite të përvojës së punës, kusht i kërkuar sipas nenit 17 të KKS, për fitimin e shpërblimit jubilar prej një page mujore, për këtë arsye kërkesëpadia e paditësit, refuzohet si e pathemeltë. Gjykata vërtetoi se paditësi marrëdhënien e punës pranë të paditurës e ka themeluar me datë 14.11.2002 ku edhe vazhdon të punojë dhe 10 vite përvojë pune i ka arritur me datë 14.11.2012, që do të thotë në periudhën kur Kontrata Kolektive Sektoriale e datës 11.06.2018 nuk ka qenë në zbatim. Andaj bazuar në nenin 17 të kësaj kontrate ku përcaktohet se punëtorëve shëndetësore për 10 vite të përvojës së punës në institucione shëndetësore, përfitojnë shpërblimin jubilar në vlerë të një page mujore të tij, del se kërkesa e paditësit është e pabazuar sipas rregullave të përcaktuara në Kontratën Kolektive Sektoriale.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, u bazua në nenin 450 të LPK-së, përkatësisht paditësi e ka humbur kontestin ndërsa e paditura nuk i ka kërkuar.

Nga arsyet e cekura me lart dhe bazuar në dispozitat e nenit 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2022:171800, 28.02.2024

Gjyqtari

Baki Shigjeqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.